



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Nr.VL-101/24 Datë:13.05.2024
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimit 01 Nr. 016-24226 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 29.04.2024

I nderuar kryetar Muharremaj,
I nderuar kryesues Kuqi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimit 01 Nr. 016-24226 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 29.04.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Suharekës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi 01 Nr. 016-24226 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 29.04.2024

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të vendimit të lartshënuar, konstatoi se:

Pasi vendimi nuk ka të bashkëngjitur pjesën grafike që ndihmon ta kemi më të qartë se në kuadër të cilës sipërfaqe të fshatit Delloc do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm dhe duke pas parasysh që një pjesë e zonës Kadastrale të Fshatit Delloc është në kuadër të Zonës së Veçantë të Parkut Kombëtar "Mali Sharr", atëherë kërkohet që të dorëzohet ekstrakti nga Harta Zonale e Komunës Suharekës që të informohemi se për cilën sipërfaqe të zonës kadastrale të Dellocit do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm, në mënyrë që të japim një vlerësim më të saktë të ligjshmërisë.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

